



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:029131

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05741810

**P.nr.88/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani Rahimi, në çështjen penale ndaj të pandehurve – personit juridik “.. “.....me seli në rrugën”.... “ pn, Lipjan, të cilin e përfaqëson avokatja me autorizim zëvendësues Arbenita Aliu për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së dhe H... K.. nga fshati G...Komuna e Pr..., me vendbanim në Rr. “ Qemajl Stafa”, të cilin me autorizim zëvendësues e mbron avokate Besjana Ismajli, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.925/2021 të datës 06.02.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 25.04.2024, e shpalli, ndersa perpiloi me date 17.05.2024 këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurve: **1.....** me nr. fiskal ..., me seli në rr”....”p.n. në Lipjan me numër 810011461.

**2. H... K...** nga babai O... dhe nëna Gj... e lindur R... i lindur me date .... në Prishtinë, ku edhe jeton në Rr. “ ....., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **JANË FAJTOR**

### **S E P S E**

### **I**

**E pandehura; .....**me seli në rr”....”p.n. në Lipjan.

Me datë 06.09.2018, në kohë të papërcaktuar në fshatin Velekincë Komuna e Gjilanit , e pandehura “....K, me nr. biznesit ..., me seli në rr”....”p.n. në Lipjan, me pronar Habil Krasniqi, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, ka hapur një lokal , me lojëra të fatit cilat lojëra janë të ndaluara sipas Ligjit mbi Lojërat e Fatit, AK 7/5ashtu që inspektorët e lojërave të fatit gjatë vizitës dhe ,kontrollimit dhe verifikimit

kanë takuar punëtorin dhe kanë hasur veprimtari të lojërave të fatit, njësi pa licencë të bastores e përcaktuar sipas nenit 25 dhe 70 të ligjit për lojërat e fatit , në këtë mënyre i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe ligjin mbi lojërat e fatit, duke e dëmtua buxhetin e Republikës së Kosovës, në vlerë të papërcaktuar.

**-me çka ka kryer veprën penale ,Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të pa ligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së.**

## II

### I pandehuri:H... K...,

Me datë 06.09.2018, në kohë të papërcaktuar në fshatin..., i pandehuri H... K.... pronar i “....., me nr. fiskal ..., me seli në rr”..”p.n. në Lipjan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, ka hapur një lokal , me lojëra të fatit ,njësi pa licencë të bastores e përcaktuar sipas nenit 25 dhe 70 të ligjit për lojërat e fatit, ashtu që ka ushtruar aktivitet, pa licencë të bastores ku në lokalin në fjalë, janë luajtur, lojërat elektronike KENO , të ndaluara me ligj, në këtë mënyre i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe ligjin mbi lojërat e fatit , duke e dëmtua buxhetin e Republikës së Kosovës, në vlerë të papërcaktuar.

**-me çka ka kryer veprën penale ,Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të pa ligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në mes të pandehurve dhe Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjiilan dhe në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, dhe 72 si dhe neni 230 dhe 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit e lartcekur :

## I GJYKON

**I.Të pandehurën: Personin juridik “...me numër të biznesit .... me seli në Rrugën “...me pronar ....., i shqipton dënim me gjobë në shumë prej ( njëmijë)1.000euro, i cili denim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.**

**II. Të pandehurit H... K... i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Mirëpo me pëlqimin e të pandehurit në kuptim te nenit 44 te KPRK-së, I ZËVËNDSOHET në dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind(700)euro, të cilën shumë duhet ta paguaj ne 4 këste te barabarta duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisëse këtij aktgjykimi.**

III Obligohen të pandehurit “..” SHPK dhe i akuzuari H.. K... që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 (njëzet) euro, si dhe taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, më datë 06.02.2023, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarve- personit juridik “....., me seli në rrugën”....., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së dhe H... K... nga fshati G... Komuna e P....., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datën 06.10.2023, në këtë gjykatë është dorëzuar marrëveshja për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i Përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit .... i cili është edhe pronar i personit juridik me mbrojtësit e tij. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarës së parë personit juridik “....., me seli në rrugën”.... “ pn, L..., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së, ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu edhe ndaj të akuzuarit të dytë ....., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata konform nenit 230 të KPRK-ës, më datën 25.04.2024 ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë të lidhur në Prokurori, ku kanë prezantuar, prokurori i shtetit, i akuzuarit me mbrojtësin e tij me autorizim, në të cilën seancë gjykata pasi që ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore, ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

### **2.Pretendimet e palëve**

Prokurorja i shtetit, ka deklaruar se duke e marrë parasys, që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore , të parapara sipas nenit 230 te KPP, për lidhjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, si dhe të gjitha rrethanat lehtësuese, që shkojnë në favor të të akuzuarve, ka kërkuar nga gjykata, që ta aprovojë këtë marrëveshje dhe dënimin e arritur sipas kësaj marrëveshje.

Përfaqësuesi me autorizim i të pandehurës “ .... av. .. ka deklaruar se është lidhur marrëveshja në mes të Prokurorisë me datë 05.10.2023 dhe janë dakorduar që kjo marrëveshje është arritur konform nenit 230 të KPPK-së dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi .

I pandehuri Habil Krasniqi- pronar i “Loni Sport “ SHPK, ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësës së tij.

Mbrojtësja e të pandehurit ..... sipas autorizimit avokate Besjana Ismajli ka deklaruar se se është lidhur marrëveshja në mes të Prokurorisë me datë 05.10.2023 dhe janë dakorduar që kjo marrëveshje është arritur konform nenit 230 të KPPK-së dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi.

### **3.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 25.04.2024, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari .... i cili është edhe pronar juridik i të pandehurës Loni Sport SHPK dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tij, se i pandehuri nuk ka qenë në asnjë mënyrë i detyruar apo i shtrënguar të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

### **4.Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të këtyre veprave penale, ekziston fakti se i akuzuari personi juridik “....., ka kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i akuzuari ....., ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **5.Elementet e veprës penale**

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, i ka shpallur fajtor të akuzuarit, për shkak të veprave të lartcekura. Ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat janë dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i akuzuari Habil Krasniqi i ka pranuar edhe vet veprat penale për të cilat është përgjegjës.

### **6.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprave penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69,70,71, dhe 72 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë lehtësuese është fakti se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjiilan/Departamenti i Përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i akuzuari ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre penale, se i njëjti më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që

në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese janë, përgjegjësia penale dhe rrezikshmëria shoqërore.

**7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësive penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.**

Gjykata, ka konstatuar se me denimin si në dispozitiv të aktgjykimit, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar nënin 452 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë secilin veç e veç për ti paguar, taksën për viktimat e krimit, shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në ninin 462 paragrafi 2 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.88/2023 Më datë 17.05.2024**

**Bashkëpunatore profesionale**

Vlora Selmani Rahimi

**Gjyqtari,**

Veli Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE** : Ky aktgjykim është i formës së prerë, ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 230 të KPRK-së me date **25.04.2024 viti**.